

# 2024



KOMUNA OBILIQ  
OPSTINA OBILIQ  
MUNICIPALITY OBILIQ

*RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE  
EKZEKUTIVIT KOMUNAL*

**Janar –Dhjetor 2023**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 02-020-01-5038-24

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg \_\_\_\_\_

Data / Datum / Date 15-02-2024

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq



### Zyra e Kryetarit

Kabinet Predcednika/ Office of the Mayor

Datë/Data/Date:	15 Shkurt 2024
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës z.Xhafer Gashi
Për/Za/To:	<del>-Kryesuesen e Kuvendit Vlora Mjekiqi - Kabashi</del> -Anëtarët e Kuvendit Komunal
Tema/Subjekat/Subject	Raporti vjetor 01 Janar -31 Dhjetori 2023

Përshëndetje e nderuara Kryesues ,  
Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal

Ju lutem që në mbledhjen e Kuvendit Komunal në muajin Shkurt ta shqyrtoni :

**RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVI KOMUNAL PËR VITIN  
2023**

Ju faleminderit për bashkëpunim !

# FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS

## XHAFER GASHI

.....

*Qytetarë të Obiliqit ,*

*Anëtar të Kuvendit ,*

*Si rezultat të punës dymbëdhjetë mujore të angazhimit maksimal në shërbim të qytetit dhe fshatrave , ju paraqes raportin vjetor për vitin 2023 para jush dhe Kuvendit Komunal .*

*Raport ky i projekteve dhe të arriturave dhe sfidave të cilat na presin së bashku ! Raport ky që së bashku hartuam buxhet , mbikëqyrëm së bashku dhe së bashku ju gëzuam investime*

*Ky raport pasqyron angazhimet tona të përbashkëta për aktivitetet , arritjet, sfidat dhe planet për të ardhmen e qytetit tonë.*

*Raporti vjetor i punë sonë është mjet i rëndësishëm për transparencën tonë të plotë dhe llogaridhënien para jush .*

*Risi për vitin 2023 ishte edhe forma e re e hartimit të buxhetit ‘ Buxheti me pjesëmarrje ‘ , formë kjo që u realizua në fshatin Mazgit.*

*Viti që lamë pas ishte vit i vështirë për të gjithë ne , por së bashku me ju kemi arritur që të përmbushim obligimet karshi jush , duke qene së bashku kemi arritura të kalojmë të gjitha sfidat së bashku .*

*Vit ky që u prekum nga kriza globale e rritjeve të çmimeve dhe inflacionit , ishte viti më i rëndë pas pandemisë , kur ekonomia kosovare dhe shoqëria jonë u sfidua edhe me këtë sfidë, në qeverisje lokale dhe ajo nacionale jemi munduar të jemi të pran jush.*

*Ne me vendimet e marra jemi munduar që sa do pak të zbusim këtë krizë, që nga lindja, shkollimit , udhëtimi , transporti , subvencionet deri tek shërbimet mortore .*

*Viti 2023 ishte vit i sfidave dhe suksese tona të përbashkëta .  
Ne raportimet tona me ju ne dy here brenda viti ju kemi informuar për punën dhe sfidat e përbashkëta*

*Bazuar në Grantin e Performancës së Komunave të Kosovës*

*Komuna Obiliqi - vendi i II-të , 2022  
Synimi ynë në vitin vijues të jemi vendi I-rë.*

*Këto të arritura janë fal jush me kontributin e dhënë në dëgjimet buxhetor e takimet tjera , ku ju keni kryet obligimet qytetare duke bërë që buxheti ynë i planifikuar të realizohet në masën prej **97.83%** , edhe pse kemi marr vendim në Kuvend Komunal për lirim të gjithë taksapaguesi e Obiliqit në shumën deri në 100 €.*

*Dhe shpenzimi i buxhetit për investime kapitale për vitin 2023 në masen prej **99.72%***

*Kjo është puna e pa lodhshme e zyrtarëve komunal dhe ekipit mbështetës .*

*Trasfomimi i qyteti në zonë urban moderne .*

*Ka filluar projekti më madhore deri me tani ‘ ‘ Koogjenerimi –Shtrirja e rrjetit të Sistemi të ngrohjes qendrore në Obiliq ‘ ‘*

*Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqi 2023-2030 – , Zgjerimi i Sheshit të Qytetit .Veqova këto tre aktivitet më madhore duke mos lënë anash edhe tjerat.*

*Kemi vazhduar me investimet kapitale ne infrastrukturë, arsim, shëndetësi , kulturë , rini sport etje .*

*Qyteti i Kulturës – ishte vit i aktivcitate të mëdha kulturore për qytetin dhe qytetarët .*

*Bashkëpunimi me Institucionet Qendrore , donatorët , e organizata tjera i vazhdueshëm .*

*Parteritet me USIAD , OSBE , DEMOS , Ambasadat ,Bankën Botërore ,BE-në .*

*Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal së bashku me ju kemi arritur që planin vjetore të punës ta realizojmë dhe buxhetin e planifikuar ta menagjojmë ne mënyrën me të mrë të mundëshem .Po ashtu ju kemi raportuar ne baza tre mujore për gjendje financiare dhe raportin vjetor .*

## Përmbledhje

---

Fjala e Kryetarit	2
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme-	5
DKRS –	11
DREJTORIA E ARSIMIT -	25
DSHMS -	41
Drejtoria e Inspektionit	71
DSHPE –	72
DMM –	80
DBZHR -	82
Drejtoria e Infrastrukturës Lokale –	84
DEFZH –	88
DPUPK –	97
Njësia e Burimeve Njerëzore –	124
Zyra ligjore -	126
Njësia e Auditimit të Brendshëm	128
Njësi Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore	130
Zyra për Integritet Evropian -	138

## **DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME**

## **HYRJE**

Drejtoria e Administratës në kuadër të kompetencave të saj dhe në përputhshmëri me legjislacionin dhe aktet normative në fuqi, ka kryer punët administrative jo vetëm në shërbim administrative për qytetarët e komunës së Obiliqit.

Duke pasur parasysh të gjitha përgjegjësit, Drejtoria e Administratës gjatë vitit të lamë pas në mënyrë profesionale është kujdesur që të jenë sa më pranë qytetarëve të Komunës së Obiliqit., duke tentuar të gjejë zgjidhje për çdo çështje të adresuar pranë kësaj Drejtorie.

Duke qenë se në vazhdimësi po tentojmë të përmirësojmë shërbimet tona, në hyrje të objektit të komunës, kemi vendosur kutinë e ankesave dhe kutinë e lëvdatave, ku në këtë mënyrë qytetarët kanë mundësi të na ndihmojnë që të kryejmë një punë profesionale. Përkushtimi ynë që shërbimet administrative për qytetarët të jenë sa më të shpejta, drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka funksionalizuar E-kioskun në Komunën e Obiliqit të cilat shërbime ofrohen çdo ditë çdo 24 orë. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, ka thelluar përkushtimin për t'ju sjellë eksperiencën më të lehtë dhe efikase të mundshme në marrjen e shërbimeve komunale. Për këtë qëllim, kemi funksionalizuar platformën tonë të re të aplikimeve online, tani ju keni mundësinë të aplikoni për shërbimet tona nga komoditeti i shtëpisë tuaj, pa pasur nevojë të vizitoni zyrat tona ose të pritni në radhë.

Në këtë raport vjetor, jemi munduar të përfshijmë të gjitha detyrat e Drejtorisë së Administratës gjatë vitit 2023, të ndara nëpër sektorët përkatës.

### **Në vijim gjeni raportet e detajuar për secilin sektor:**

## **SEKTORI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME**

Sektori i Administratës kryen të gjitha punën profesionale, juridike të Kuvendit dhe Komuniteteve obligative dhe mbikëqyrë punët në QSHQ(Qendra e Shërbimit për Qytetarë).

Ky sektor përgatit të gjitha vendimet sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës, prokurimit dhe njësisë kërkuese, si dhe kthen përgjigje në të gjitha kërkesat e qytetarëve të drejtuar Kryetarit dhe bordit të drejtorëve.

Në kuadër të këtij sektori janë Kuvendi, Qendra për Shërbim me Qytetar, Arkiva, Logjistika dhe Teknologjia Informative.

## **KUVENDI KOMUNAL**

Kuvendi Komunal ka mbajtur 12 seanca të rregullta, ku gjatë këtyre seancave të mbajtura ka nxjerrë 66 vendime të miratuara dhe 6 plane si dhe 1 strategji.

### **1: Plani për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale 2023- 2028**

**2: Plani për Ri-integrimit të Qëndrueshëm të Peronave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023- 2025**

**3: Plani i Veprimit për Transparencë 2023 – 2027**

**4: Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit**

**5: Plani i Punës së Kuvendit Komunal Obiliq për vitin 2024**

**6: Strategjia për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal 2023-2027**

**7: Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore për vitin 2024-2026**

Gjithashtu gjatë vitit janë mbajtur 3 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 2 mbledhje solemne.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 12 seanca;

Komunitetit për Komunitete ka mbajtur 12 seanca

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur 5 mbledhje.

## **DËGJIMET PUBLIKE**

Sa i përket dëgjimeve publike të Komunës së Obiliqit, janë mbajtur 20 dëgjime publike, si më poshtë:

- Me datën 20.02.2023 është mbajtur konsultim publik: "Draft-Plani për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale 2023-2027"
- Me datën 26.05.2023 është mbajtur takimi i parë tre mujor në kuadër të Agjencisë së Kontratës sociale.
- Me datën 23.05.2023 është mbajtur Draft Planin e Veprimit për Transparencë
- Me datën 05.06.2023 është mbajtur buxhetimi me pjesëmarrje të qytetarëve Mazgit i Epërm
- Me datën 15.06.2023 është mbajtur debati publik Korniza Afatmesme e Buxhetor për vitin 2024-2026.
- Me datën 12.06.2023 është mbajtur procesi i votimit të buxhetimit.
- Me datën 22.06.2023 është mbajtur Kornizën Afatmesme e Buxhetor për vitin 2024-2026 (KAB).
- Me datën 30.06.2023 është mbajtur "Informimi i qytetarëve rreth gjashtë (6) mujorit të parë të punës së ekzekutivit komunal për vitin 2023.
- Me datën 07.07.2023 është mbajtur prezantimi i punës rreth hartimit të Hartave Zonale për Obiliq, Obiliqi i Vjetër, Palaj, Dardhishtë dhe Plemetin, po ashtu prezantimi i punës rreth hartimit të Hartave Zonale për Mazgitin e Ulët, Mazgitin e Epërm dhe Llazareve.
- Me datën 12.07.2023 është mbajtur gratë në biznes, Star-Up dhe nënat vetushqyese.
- Me datën 04.08.2023 është mbajtur diskutimi publik "Përmasimi i kushteve të sigurisë në shkollat e fshatit Plemetin dhe shkollën Dr. "Ibrahim Rugova".
- Me datën 04.08.2023 është mbajtur diskutimi publik "Rivalitizimi i parkut të kompleksi banesor Hade 1 dhe 2.

- Me datën 16.08.2023 është mbajtur ‘Draft Plani Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025 .
  - Me datën 16.08.2023 është mbajtur “Plani Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027.
  - Me datën 17.08.2023 është mbajtur diskutimi për raportin e VSM (Vlerësim i strategjik mjedisor) të Hartës Zonale 2023 – 2031 .
  - Me datën 25.08.2023 është mbajtur takimi i dytë të tre mujorin në kuadër të zbatimit të Agjendës së Kontratës Sociale për Obiliqin.
  - Me datën 30.08.2023 është mbajtur dëgjimi buxhetor, për buxhetin e vitit 2024 dhe planifikimet për vitin 2025-2026.
  - Me datën 30.08.2023 është mbajtur dëgjimi buxhetor me Kryetarët e Këshillave Lokal për investimet kapitale për vitin 2024-2026 .
  - Me datën 15.09.2023 Kryesuesja e Kuvendit Komunal ka mbajtur takimin publik për Planifikimin e Buxhetit për vitin 2024-2026.
  - Me datën 19.09.2023 është mbajtur diskutimi publik me të rinjtë e Komunës së Obiliqit.
  - Me datën 20.09.2023 është mbajtur diskutimi publik me pensionistët e Komunës së Obiliqit.
  - Me datën 20.09.2023 është mbajtur diskutimi publik me komunitetet të cilët jetojnë në fshatin Plemetin.
  - Me datën 22.09.2023 Kryesuesja e Kuvendit së bashku me kryetarin e Komunës kanë mbajtur diskutimin publik për dëgjimet buxhetore komunale për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025-2026 me kryetarët e Kryetarët e Këshillave Lokal dhe atë të fshatrave.
  - Me datën 12.10. 2023 drejtorja për Planifikim Urbani, Pronë dhe Kadastër ka mbajtur diskutim publik me bizneset, ndërmarrjet publike me bizneset.
  - Me datën 31.10.2023 është mbajtur takimi i tretë të tre mujorit në kuadër të zbatimit të Agjendës së Kontratës Sociale.
  - Me datën 13.12.2023 është mbajtur diskutimi publik për Draft-Matricën “Planoi Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026”.
  - Me datën 19.12.2023 është mbajtur diskutimi për “Strategjinë Socio-Ekonomike të Komunës së Obiliqit 2023-2027.
  - Me datën 27.12.2023 është mbajtur diskutimi për ‘Draft-Statutin e Bibliotekës komunale për Obiliq.
  - Me datën 27.12.2023 është mbajtur takimi “Informimi i qytetarëve rreth gjashtë (6) mujorit të dytë të punës së ekzekutivit komunal për vitin 2023.
- Gjatë periudhës raportuese kemi pasur 7 kërkesa për qasje në dokumentet publike zyrtare, të gjitha të aprovuara.

Gjithashtu në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme bëhet edhe përkthimi shqip-serbisht dhe anasjelltas i të gjitha materialeve për KK dhe komitetet obligative, rregulloreve, vendimeve dhe materialeve tjera sipas kërkesave të drejtorive.

## **ARKIVA**

Zyra e arkivit (shkrimorja)e komunës mbahet në mënyrë elektronike-manuale, ku gjatë kësaj periudhe 1 vjeçare ka proceduar 9038 lëndë.



## QENDRA E SHËRBIMEVE PËR QYTETARËT

Sa i përket QSHQ(Qendra e shërbimit për qytetarë), janë kryer punët e përditshme në pranim-dorëzimin e kërkesave të qytetarëve, dhënia e informacioneve qytetarëve, ndihma dhe këshilla e nevojshme për realizimin e kërkesave dhe ankesave të tyre.

Këto punë (lëndë) kryhen përmes intranetit dhe librave përkatëse, ku për periudhën raportuese paraqesim statistikën sipas programit, si më poshtë:

Pranuar–**12** lëndë;

Në proces – **1,437** lëndë;

Të miratuara–**12,012**lëndë;

Të refuzuara–**924** lëndë;

Të hedhura poshtë – **12**lëndë;

Të pezulluara – **30** lëndë;

Të çeduarda – **30**lëndë;

Të anuluarat – **33** lëndë;

Të përfunduara–**22,222** lëndë;

Gjithsej –**36,689** lëndë.

Sa i përket sistemit Intranet, afati dhe shqyrtimi i kërkesave është 30 ditë, mirëpo meqenëse drejtorinë përkatëse në Komunën e Obiliqit, çdo vit ndajnë subvencione të natyrave të ndryshme, është e pamundur që të gjitha kërkesat të shqyrtohen brenda afatit të sistemit. Kjo vjen si pasojë e faktit se kërkesat grumbullohen deri në përfundim të afatit për aplikim, dhe pas mbylljes së afatit fillon shqyrtimi i tyre.

Zakonisht, kërkesat e shqyrtuara jashtë afatit, janë të Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të gjitha drejtorive të tjera që ndajnë subvencione për qytetarët e Komunës së Obiliqit.

## LOGJISTIKA

Nga zyrtarja e logjistikës në Drejtorinë e Administratës, janë realizuar Hyrje-Dalje nga depoja për administratën komunale, institucionet arsimore si dhe institucionet shëndetësore. Po ashtu janë realizuar kërkesat për material administrativ hyrje-dalje në sistemin E-pasurisë gjithashtu edhe hyrjet në thesar, për të gjitha lëndët e prokurimit.

## TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Gjate kësaj periudhë në sektorin e IT janë bërë 135 formatizime dhe instalime për kompjuterët e ri dhe janë bërë intervenime tek institucionet komunale shëndetësi, arsim si dhe shkollat e komunës si dhe janë bërë shumë punë tjera duke përfshirë krijimin në SIMBNJ 76 kyçje në sistem dhe 85 qasje në HRMIS SYSTEM si dhe krekës për ID kartela për 76 shërbyesit civil.

Në Shërbimin online janë nxjerr gjithsej 185 kërkesa dhe janë kthyer përgjigjeje. Aplikacionet komunale në të cilën bëhet administrimi i tyre nga zyrtari i IT-së janë:

Intraneti  
 E-arkiva  
 E-pasuria  
 SIMBNJ  
 SMVP  
 Domenin Mun.Gov.irk.rks  
 CMS  
 Free Balance Web Aplikacion  
 Sistemin e MPB për riadhesim  
 Softwerin për Përkthim donacion nga USAIDI  
 Menaxhimin e të dhënave personale i caktuar nga ASHMDHP (MPB) gjithsej 12 raste  
 Menaxhimin e softuerit për hapjen dhe caktimin e orarit te dyerve për hyrje dhe dalje  
 HRMIS SYSTEM  
 HRIS sistemin e menaxhimit të fermerëve , Subvencionimin ,LPIS  
 Sistemin në Kadastër KCID, KCLIS,  
 Quick Box sistemin e menaxhimit të financave,  
 Obiliqionline- shërbime Online  
 Zyrtar Alternativ i Pasurisë  
 Zyrtar për mbrojtjen e të dhënave Personale

## **SEKTORI I GJENDJES CIVILE**

Në zyrën e Gjendjes Civile gjatë periudhës janar-dhjetor/2023 janë kryer të gjitha detyrat sipas përgjegjësisë të nëpunësve civil dhe ligjeve ne ku fuqi, ku gjithsej janë dorëzuar:

Në këtë zyre gjatë vitit/2024, janë lëshuar:

Ekstrakt lindjes	13162
Certifikata të lindjes	2080
Certifikata të martesës	1898
Certifikata të vdekjes	900
Certifikata të vendbanimit	300
Certifikata të bashkësisë familjare	2045
Certifikata të gjendjes martesore	318
Certifikata të shtetësisë	74
Vërtetim nga arkivi	141
<b>Gjithsejtë</b>	<b>20918</b>

## **PROJEKTET E DREJTORISË SË ADMINISTRATËS**

Nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, gjatë kësaj periudhe, përmes prokurimit janë realizuar këto projekte si më poshtë:

“ Digjitalizimi i Zyrës Pritëse”

“Platforma për menaxhimin e proceseve të brendshëm E-Kioska”

“Blerja e pajisje teknologjike –Laptop”

“Shpenzimet e bufesë për Komunën e Obiliqit”

“Furnizim me letër”

“Furnizim me material administrativ”

Të gjitha të dhënat më lartë, janë të bazuara në raportet e sektorëve përkatës të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, në përputhje me detyrat zyrtare të nëpunësve civil brenda Drejtorisë.

## **DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

### ***PËRMBLEDHJE***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Obiliqit, gjatë periudhës njëvjeçare të punës (janar-dhjetor 2023), ka përfunduar aktivitetet të planifikuara në kuadër të Planit vjetor të Punës për vitin 2023, bazuar në kompetencat, objektivat dhe synimet e përgjithshme të drejtorisë duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore, sportive e rinore të Komunës së Obiliqit.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Obiliqit, e përbërë prej sektoreve: Kulturë, Rini, Sport dhe ai i Bibliotekës, me një buxhet të planifikuar për vitin 2023, ka realizuar aktivitete e projekte në kuadër të këtyre tri sektoreve.

Personeli i DKRS-së, ka bërë përpjekje maksimale në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbushur planin e punës, qëllimet dhe objektivat për vitin 2023. Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e nivelit lokal, institucionet kulturës dhe artit të nivelit qendror, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara gjatë kësaj periudhe.

Në këtë raport njëvjeçar (janar-dhjetor) të punës janë të përfshira aktivitetet e zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitetet e projektet në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e artitekonike, sportit dhe rinisë.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport konsideron se ka arritur me sukses realizimin e objektivave të planifikuara gjatë vitit, duke realizuar aktivitete të shumta kulturore, sportive, rekreative dhe rinore.

#### Aktivitetet e DKRS-së në periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2023:

##### ***Përgaditja dhe hartimi i Planit të Punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2023***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport duke u bazuar në synimet dhe objektivat e përgjithshme, ka hartuar një Plan të pasuruar të Punës për vitin 2023, duke realizuar kështu një sërë aktivitete të kulturore, artistike, sportive e rinore, në bashkëpunim me OJQ-të e komunës së Obiliqit. Personeli i DKRS-së, ka përmbushur planin e punës, qëllimet dhe objektivat për vitin 2023.

##### ***Formimi i Këshillit Organizativ për organizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së DKRS-së për vitin 2023***

Me vendim të Kryetarit të Komunës, është formuar Këshilli Organizativ për organizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së DKRS-së për vitin 2023, me qëllim të bashkërendimit, koordinimit të mirëfilltë në realizimin sa më të suksesshëm të aktiviteteve.

##### ***Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga DKRS-ja nga viti paraprak***

Zyrtarët e DKRS-së, kanë pranuar raportet financiare dhe narrative të ojq-ve kulturore, sportive e rinore që kanë qënë përfituese nga thirrjet publike për subvencionim gjatë vitit 2022.

##### ***Në bashkëpunim me Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale, DKRS-ja ka hartuar projektet kapitale lidhur me investimet e nevojshme në fushat përkatëse***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka realizuar projektin – Ndërtimi i Shtatores së Heroit “Fahri Fazliu”, i cili është përfunduar me datë 5 Maj- Ditën e Dëshmorëve të Kombit.

Në fushën e trashëgimisë, ka realizuar projektin – Rregullimi i Mullirit të Behramajve.

##### ***Përgaditja e planit të prokurimit për projektet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe projekteve kapitale.***

##### ***Përgaditja e projekteve, paramasave dhe parallogarive në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.***

DKRS-ja, gjatë vitit 2023 ka patur të planifikuara vlerën prej 101.937.00€, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, të cilat i ka shpenzuar në total në realizimin e projekteve të ndryshme të sektoreve brenda drejtorisë.

##### ***Shpallja e Thirrjes Publike për subvencionim nga DKRS-ja për vitin 2023***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të kategorisë së subvencionimit, për vitin 2023 ka planifikuar vlerën prej 175 mijë euro, ku përmes dy thirrjeve publike (Thirrja e I: XIV-56 me datë

20.03.2023 dhe Thirrja e II:XIV-117 me datë 08.06.2023), ka ofruar mbështetje financiare të gjitha organizatave jo-qeveritare kulturore, sportive, rinore si dhe individëve të regjistruar në Republikën e Kosovës, që veprojnë në komunën e Obiliqit, programi i të cilave është i fokusuar në ruajtjen e traditës kulturore, fuqizimin dhe avancimin e të rinjëve dhe sportit.

### ***Organizimi i takimit me OJQ-të, klubet sportive e shoqatat kulturore***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, në fillim vit ka organizuar takime me OJQ-të, klubet sportive e shoqatat kulturore që veprojnë në komunën e Obiliqit, në këto takime u njoftuan nga afër me Planin e Punës së drejtorisë për vitin 2023, për mundësit e bashkëpunimit në realizimin e objektivave të përbashkëta përgjatë vitit, me qëllim të rritjes së aktiviteteve por dhe nxitjes së pjesëmarrjes së të rinjëve në aktivitete sportive. Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport ka zhvilluar edhe takime të tjera gjatë tre mujorit të dytë (Maj 2023) për të bashkërenduar aktivitetet për muajin Qershor- Muaji i Krenarisë sonë dhe muajit Korrik- ditëve të diasporës. Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, ka zhvilluar edhe takimet gjatë tremujorit të tretë (Gusht 2023) për të bashkërenduar aktivitetet për Javen Rinore 2023.

### ***Shfaqja “SISTERS” nga Baleti Kombëtar i Kosovës***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Baletin Kombëtar të Kosovës, kanë sjellur shfaqjen “SISTERS” të koreografit të njohur Mehmet Balkan, në sallën e Shtëpisë së Kulturës “Xhavit Haziri”. Baleti Kombëtar i Kosovës, është shfaqur për herë të parë në Obiliq, me datë 20 janar 2023, duke sjellur shfaqjen “Sisters”, një vepër origjinale e koreografit Balkan e cila hynë te baletet neo-klasike, ku lëvizjet e sofistikuara të balerinëve të BKK, ndërthuren me interpretimin emocional të secilit balerin në skenë, për ta bërë kështu një shfaqje të kompletuar artistike dhe të pëlqyer për publikun.

### ***Shënimi i 15- vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës***

Për nder të 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është shënuar kjo ditë me një sërë aktiviteteve;

Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e qytetit të Obiliqit.

Ceremonia e homazheve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Turniri në Basketboll, me gjeneratat e reja dhe pjesëmarrjen e ekipeve nga Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi- ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Klubin “KB KEKu”.

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është mbajtur manifestimi kulturor-artistik për nder të 15 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, me pika artistike të zgjedhura nga bashkëpunimi me Gjimnazin "17 Shkurti", Ansamblin e Qytetit dhe nxënëset nga SHFMU

"Dr.Ibrahim Rugova", sollën një atmosferë të jashtëzakonshme të bërë në veçanti për këtë ditë feste.

### ***Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Ministrin e MKRS-së, z.Hajrullah Çeku***

Përmes një ceremonie të organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Bibliotekat Komunale, Drejtoresha e DKRS-së, Arba Mirena, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimit me Ministrin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z.Hajrullah Çeku, për mbështetje financiare për pasurimin e fondit librar, me këtë rast Biblioteka e Qytetit është furnizuar me 1110 ekzemplarë librash, gjatë vitit 2023, bazuar në këtë memorandum bashkëpunimi.

### ***“Edukimi i bazuar në Teatër”***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me grupin teatral të Qytetit të Obiliqit dhe organizatën Artpolis, kanë realizuar projektin **“Edukimi i bazuar në Teatër”**, përmes këtij projekti janë identifikuar të rinjtë e të rejtat me pasion dhe talent në fushën e teatrit, ku përreth dy muaj do të përgaditën në aspektin profesional teatror nga anëtar të Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe në përfundim do të realizohet një forum teater për publikun. Ky projekt ka filluar në fillim të muajit Mars dhe pritet të përfundoj në fund të muajit Prill.

### ***“Të rinjtë – avokues adekuat të së ardhmes”***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Qendrën Rinore dhe MKRS-në, kanë realizuar projektin **“Të rinjtë – avokues adekuat të së ardhmes”**, qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes së të rinjëve, ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe avansimin rinor për qytetari aktive përmes promovimit të vullnetarizmit dhe monitorimit të politikave lokale.

### ***“FINAL FOUR” turniri në basketboll***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe Klubin KB KEKu, kanë realizuar eventin sportiv "Final Four" me gjeneratën U16, me 18 Mars 2023 në Palestrën Sportive "Adem Jashari", për të vazhduar me finalen të diele e 19 Marsit.

### ***Garat Komunale me shkollat***

Në kuadër të kalendarit të garave sportive, DKRS-ja në bashkëpunim me DKA-në dhe Shoqatën e Pedagoqeve, kanë organizuar garat komunale në:

Sportin e Basketbollit, fituesit e kësaj gare dolën: Gjinnazi “17 Shkurti” dhe SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova” me ekipin e vajzave dhe djemëve. Fituesit e këtyre gara kanë përfaqësuar komunën e Obiliqit në garat regjionale, ku kanë arritur rezultate maksimale duke u renditur në vendet e para. Sportin e Futsallit, fituesit e kësaj gare dolën: SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova” ekipi i vajzave dhe djemëve , Gjinnazi “17 Shkurti” ekipi i vajzave dhe SHMLP “Ismail Dumoshi” ekipi i djemëve.

### ***Shënimi i Javës Aerounatike të Kosovës- “Kastriot Open 2023”***

Në bashkëpunim me Klubin e paraglajding-ut “Shqiponjat e Kastriotit”, në Stadiumin “Agron Rama”, është shënuar Java Aerounatike e Kosovës “Kastriot Open 2023” e cila ka filluar nga data 04 Maj 2023 dhe prej katër ditësh është shënuar me aktivitete të shumta që lidhen me këtë sport.

### ***Shënimi i 5 Majit- Dita e Dëshmorëve të Kombit – Përvendimi i Shtatores së Heroit të Kombit FAHRI FAZLIU***

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, është shënuar 5 Maji- Dita e Dëshmorëve të Kombit, ku pikërisht në këtë ditë është bërë zbulimi i shtatores së Heroit të Kombit, Fahri Fazliu. Në këtë ceremoni madhështore, prezent ishin personalitete të shquara nga gjitha trevat shqiptare, bashkëveprimtarë të Heroit të Kombit Fahri Fazliu, duke nderuar kështu jetën dhe veprën e tij. Hero i Kombit Fahri Fazliu, i shkrirë në bronz punuar nga skulptori Sabri Behramaj, u rikthye në mesin tonë, në sheshin e bukur të qytetit për të lartësuar jetën dhe veprën e tij ndër breza. Aktivitete kulturore në shënimin e kësaj ngjarje të madhe, në sheshin "Dëshmorët e Kombit", u dha nga Ansambli i Qytetit dhe me fluturimin e paraglajdistëve nga Shqiponjat e Kastriotit.

### ***Shënimi i 31 Majit - Dita Ndërkombëtare kundër Duhanit***

Në kuadër të projektit Ora e Rinisë, është realizuar ligjërata vetëdijesuese nga Qendra Rinore në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Obiliqit, për të rinjtë dhe të rejtat, duke shënuar 31 Majin- Ditën Ndërkombëtare kundër Duhanit. Dita Ndërkombëtare kundër Duhanit është një mundësi për të përmirësuar vetëdijen tonë për dëmet e duhanit dhe për të ndihmuar në formimin e një shoqërie të ndërgjegjshme që lufton këtë problem globale dhe vlerëson shëndetin e saj.

### ***Shënimi i 1 Qershorit – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe Qendrën Rinore, u përkujdesen për shënimin e 1 Qershorit –Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, u përcoll me aktivitete të shumta, fillimisht me këngë, lojëra e argëtim me Maskotat, për të vazhduar me aktivitetin "Gjurmët e së ardhmes", aktivitetin në pikturë dhe festivalin me karaoke.

### ***Shënimi i aktivitetit “Drejt Malit”***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës, Drejtorinë Komunale të Arsimit, Shoqatën e Pedagogëve të Edukatës Fizike, Klubin “Shqiponjat e Kastriotit”, Klubit të Kalërimit “Mazgiti”, është realizuar projekti “Drejt Malit”, në këtë aktivitet morën pjesë rreth 300 nxënës të klasëve të 7-të, të shkollave fillore të Komunës së Obiliqit, ku kaluan 5 km shtegë përgjatë shtegut "Rrugët të Lirisë". Në fund të hikingut, fëmijët patën aktivitete sportive shtesë dhe ligjerata informative për historinë, orientimin në natyrë dhe ndihmën e parë.

### ***Shënimi i 14 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, z.Xhafer Gashi, ka shënuar aktivitete të shumta kulturore dhe sportive në shënimin e 14 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit, duke organizuar aktivitetet si në vijim:

Shënimi i 11 Qershorit – Krisma e parë e Lirisë në fshatin Hamidi, është shënuar 25 vjetori i Betejës së Hamidisë, duke nisur kështu edhe Javën e Çlirimit në Komunën e Obiliqit.

Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e Qytetit “Dëshmorët e Kombit”.

Klubi Teatror në Obiliq prezantoi shfaqjen “Zilja kundër dhunës” : Në kuadër të aktiviteteve për Ditën e Çlirimit -14 Qershorin, është mbajtur Forum-teatri "Zilja kundër dhunës", nën përkujdesjen e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Teatrin e Qytetit të Obiliqit dhe Artpolis. Shfaqja “Zilja kundër dhunës” trajton një temë tejet sensitive dhe shqetësuese, atë të dhunës në shkolla. Duke pasur parasysh se shkollat janë tejet të rëndësishme në formësimin e mëtutjeshëm të brezave që vijnë. Shfaqja ka vënë në pah një reflektim analitik të gjendjes së tanishme dhe situatës në shkollat tona, e cila fatkeqësisht është tejet problematike. Përmes shfaqjes është synuar ndryshimi i gjendjes duke shpresuar që shkollat tona të jenë vende drite e dashurie dhe jo vende ku ligësia dhe dhuna të dominojnë jetën e nxënësve, të cilët shumë shpejtë do të gjenden përballë përgjegjësi të mëdha shoqërore.

Turniri i Boksit- në bashkëpunim me Klubin e Boksit “Kastrioti” dhe Federatën e Boksit të Kosovës është realizuar Turniri i Boksit në Amfiteatrin e Sheshit të Qytetit, tashmë i shëndrruar në turnir tradicional në Obiliq.

Manifestimi Qendror për Ditën e Çlirimit – Komuna e Obiliqit ka përmbyllur aktivitetet për Ditën e Çlirimit, me Manifestimin Qendror, i mbajtur në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”, i realizuar në bashkëpunim me Ansamblin e Këngëve dhe Valleve “AKV Qyteti i Obiliqit”, me pjesët artistike duke u përcjellur me ritëm këngësh nga nxënësja Deola Aliu, këngë patriotike nga këngëtarët Vesad Mjeku dhe Asim Gashi, si dhe me kolazh vallesh nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve “AKV Qyteti i Obiliqit”.

### ***Turniri në Futsall – “AutosallonAlberti – tournament”***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Klubin e futsallit “FC Obiliqi”, kanë realizuar turnirin në Futsall, i cili është zhvilluar për herë të parë në Obiliq dhe ka zgjatur prej 1 javë ( 20- 27 qershor 2023), nën pjesëmarrjen e mbi 30 ekipeve nga gjithë Kosova.

### ***Shënimi i 26 Qershorit- Dita Botërore e luftës kundër abuzimit të drogave dhe trafikimit të paligjshëm***

Në hapësirat e Gjimnazit "17 Shkurti" dhe SHMLP "Ismail Dumoshi", në kuadër të Orës Rinore, është shënuar 26 Qershori- Dita Botërore e luftës kundër abuzimit të drogave dhe trafikimit të paligjshëm, përmes ligjëratës vetëdijësuese të mbajtur nga Qendra Rinore, nxënësit e shkollave k



anë patur mundësin të njoftohen nga afër me temen e abuzimit me droga dhe trafikimit të paligjshëm. Kjo ligjeratë është mbajtur në kuadër të projektit "Ora Rinore", realizuar nga Qendra Rinore dhe mbështetur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

### ***Gara në sportin e notit***

Në kuadër të ngritjes së numrit të aktiviteteve, është zhvilluar gara në sportin e notit, me 250 pjesëmarrës nga 15 klube të Kosovës, e organizuar nga Klubi Notit "Obiliqi" dhe i përkrahur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Obiliqit. Ky aktivitet, ka synuar të promovojë dhe inkurajojë sportin e notit në vendin tonë, duke realizuar kështu një garë me klubet më të mira të notit në gjithë Kosovën.

### ***Shënimi i Ditëve të Diasporës***

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, shënojmë Ditët e Diasporës, me një sërë aktivitete:

**Premiera e komedisë së shfaqjes: “Zojsi maskohet si mëzat”**, i realizuar në bashkëpunim me Teatrin e Qytetit të Obiliqit,

**Dita e filmit për fëmijë**, shfaqja e filmit me dublim shqip “Harri Poter dhe guri filozofik”,

**Panairi i ushqimeve tradicionale**, i realizuar me Shoqate ne Penzionereve të Komunës së Obiliqit,

**Koncerti “T’i këndojmë Diasporës”**, në bashkëpunim me AKV “Qyteti i Obiliqit” duke sjellur atmosferë e argëtim për qytetarët e bashkatdhetarët tanë, nën tingujt e këngëve të artistëve dhe valleve të bukura shqipe.

### ***Realizimi i projektit “ArtVox” dhe vizita e Ministrit të MKRS-së, Hajrullah Çeku***

Në kuadër të aktiviteteve për muajin e Rinisë, është realizuar projekti "Artovox" nga vullnetarët e Qendrës Rinore, në bashkëpunim dhe mbështetje financiare nga DKRS-ja, ku ka për synim mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit të pastër e të gjelbërt. Pjesë e këtij aktiviteti ishin Ministri i MKRS-së, z.Hajrullah Çeku dhe Kryetari i Komunës së Obiliqit, z.Xhafer Gashi.

### ***Shënimi i Javës Rinore në Komunën e Obiliqit***

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, në përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Obiliqit është shënuar Java Rinore, me përplot aktivitete sportive e rinore në bashkëpunim me OJQ-të e Komunës së Obiliqit, duke u përkujdesur që në aktivitetet e

planifikuara të përfshihen të gjitha grupmoshat rinore. Java Rinore ka filluar nga data 17 Shtator 2023 deri me datën 24 Shtator 2023, me aktivitetet si në vijim:

**Turniri në Streetball "3x3 Obiliq"**, në bashkëpunim me Klubin e basketit KB KEKU, i mbajtur në Sheshin e qytetit "Dëshmorët e Kombit" nën pjesëmarrjen e dymbëdhjetë (12) ekipeve.

**Drama për fëmijë "Rrëfime nga Xhungla"**, e mbajtur në Shtëpinë e Kulturës "Xhavit Haziri" në bashkëpunim me Teatrin e Qytetit të Obiliqit.

**Trajnimi "Aftësimi i të rinjve për shkathësi të buta"**, ky trajnim ka përfshirë tridhjetë (30) pjesëmarrës të ndara në dy grupe, ku janë përfshirë gjashtë (6) module: rritja e shkathësisë për kërkim pune, aftësia e komunikimit, zhvillim personal dhe aftësi negociuese, menaxhimi i kohës, mendimi kritik dhe zgjedhja e problemit, intelegjenca emocionale dhe orientimi në karrierë, trajnimi është mbajtur në Bibliotekën e Qytetit, target-grupmosha 16-20 vjeç, me drejtuesen e projektit z. Altuna Ismajli, si dhe në fund të trajnimit pjesëmarrësit janë çertifikuar me çertifikat për pjesëmarrje.

**Ekspozita personale "Te dua" nga Betim Bregovina**, kjo ekspozitë ka përfshirë fotografi nga objektet e trashëgimisë kulturore në Obiliq por edhe në qytete të tjera nga perspektiva e Betimit, e mbajtur në Shtëpinë e Kulturës "Xhavit Haziri".

**Turnir në futboll me grupmoshat e reja**, ky turnir është organizuar në bashkëpunim me shkollat e futbollit në Komunën e Obiliqit, ajo e KEK-ut, Urbano, Ardhmëria dhe Liria 01, në stadiumin "Agron Rama" në Obiliq. Karakteri i turnirit ishte miqësor dhe fitues i tij doli KEK-u.

**Dita e Filmit për fëmijë "Mavka-the forest song" me titra në shqip**, ky film u shfaq në amfiteatrin e Sheshit të Qytetit, duke u shëndrruar në një kinema të hapur për fëmijët tanë të dashur.

**Një ditë me Policinë e Kosovës**, në kuadër të aktiviteteve të Javës Rinore, në ditën e është realizuar një aktivitet të veçantë, me ata të cilët ruajnë rendin dhe sigurinë e qytetarëve dhe me fëmijët që kanë të tashme dhe të ardhme të sigurt fal institucionit më të besueshëm të sigurisë siç është Policia e Kosovës. Në bashkëpunim me Statcionin Policor të Obiliqit dhe DKA-në, është shënuar aktivitetit "Një ditë me Policinë e Kosovës", ku nxënësit e klasëve të shtata (7) të SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" patën rastin të njihen nga afër me punën që zyrtarët policor realizojnë gjatë një dite, rëndësinë që ata kanë në ruajtjen e rendit në komunikacion dhe sigurinë e qytetarëve.

**Rekreacion në kalërim në Graboc**, nën peizazhin e bukur natyror në fshatin Graboc, tek Mulliri i Hysenajve, në bashkëpunim me Klubin e kalërimit "Mazgiti" është zhvilluar rekreacion në kalërim. Të rinjtë prezent e shijuan në maksimum këtë rekreacion të realizuar në kalërim si dhe ambientin e bukur tek mulliri në Graboc.

**Hiking në Liqenat-Rugovë**, ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Qendrën Rinore dhe u mirëprit nga të rinjtë e Obiliqit si eksperiencë e re shumë të rinjë e të reja të Obiliqit shijuan natyrën e ngrohtë duke realizuar hiking.

### ***Shënimi i 28 Nëntorit- Ditës së Flamurit Kombëtar***

Për nder të 28 Nëntorit- Ditës së Flamurit Kombëtar, daljes së parë publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ditëlindjes së Komandantit Legjendar Adem Jashari, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, z.Xhafer Gashi dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është shënuar kjo datë me aktivitetet si në vijim;

Ceremonia e homazheve në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.

Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e qytetit të Obiliqit.

Manifestimi kulturor-artistik në Shtëpinë e Kulturës "Xhavit Haziri", ky program i pasuruar kulturor u realizua në bashkëpunim me Ansamblin dhe Teatrin e Qytetit, nën tingujt e bukur me motive të festës së 28 Nëntorit, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Komandantit Legjendar Adem Jashari.

### ***Turniri tradicional në Kik-Boks***

Në kuadër të aktiviteteve sportive, në Palestrën Sportive "Adem Jashari", është mbajtur turniri tashmë tradicional në Kik-Boks, i cili është organizuar nga Klubi i Kik-Boksit "Arbër" në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Obiliqit. Në këtë garë, ishin pjesëmarrës klube nga Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi.

### ***Realizimi i projektit "Dekorimi i qytetit gjatë festave të fundvitit"***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, është përkujdesur që të ofroj ngrohtësi e atmosferë festive, qytetarëve të Komunës së Obiliqit, për festat e fundvitit! Kësisoj, ka realizuar projektin "Dekorimi i Qytetit të Obiliqit gjatë festave të fundvitit", në bashkëpunim me NPL Kastrioti Sh.A, duke zbatuar kontratën "në shtëpi"! Ndezja e dritave të festave është bërë me datë 15 dhjetor 2023.

### ***Leximi skenik i shfaqjes "Dordoleci ka hundë"***

Në kuadër të aktiviteteve për fëmijët, është realizuar leximi skenik të shfaqjes "Dordoleci ka hundë" me nxënësit e dy shkollave fillore; SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" në Obiliq dhe SHFMU "Naim Frashëri" në Breznicë. Ky projekt me autore Valmira Thaqi, është mbështetur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport- Komuna Obiliq, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë gjithë vitit është angazhuar në ngritjen e aktiviteteve kulturore, sportive e rinore, në veçanti për grupmoshat e fëmijëve, nxënësve tanë shembullor!

### ***Koncerti festiv për nder të veprimtarisë dhjetë vjeçare (10) kulturore të artistëve nga Komuna e Obiliqit, Besnik dhe Zymrije Grajçevci***

Në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”, është mbajtur koncerti festiv i QKRS “Brez pas Brezi” dhe Fidaf Kosova, në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, organizuar për nder të veprimtarisë dhjetë vjeçare (10) kulturore të artistëve nga Komuna e Obiliqit, Besnik dhe Zymrije Grajçevci.

### ***Takimi përmbyllës me institucionet lokale dhe OJQ-të sportive, kulturore e rinore***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në përmbyllje të vitit 2023, ka ndarë letër falenderim për institucionet lokale, OJQ-të kulturore, sportive e rinore, me të cilat ka bashkëpunuar gjatë vitit 2023, bazuar në Planin e Punës së DKRS-së, në realizimin e aktiviteteve kulturore, artistike, sportive e rinore. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë gjithë vitit ka realizuar aktivitete të shumta sportive, rekreative, rinore e kulturore, të mirëpritura dhe të vlerësuara nga qytetarët.

### ***Aktiviteti i përvitshëm “Sportisti i Vitit 2023”***

Në aktivitetin e përvitshëm “Sportisti i Vitit”, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, u ndanë mirënjohje për sportistët e dalluar të Komunës së Obiliqit, të cilët me talentin, punën e përkushtimin tyre po arrijnë rezultate të jashtëzakonshme duke bërë krenar gjithë qytetin e Obiliqit por edhe Kosovën. Për këtë vit, titulli “Sportisti i Vitit” i takoj karateistit, Albinot Selmani, nga klubi i Karatesë “Besa-Obiliq”, Klubi më i suksesshëm "KFV KEK-u veteranët", trajneri më i mirë Enis Nasufi, veteran i futbollit Avni Shala, po ashtu mirënjohje u ndan për sportistët që kontribuan ndër vite, për punëtorin sportiv, ambasador i vitit dhe për sportistët me perspektiv.

***Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, menaxhon me objektet kulturore, sportive dhe Bibliotekës, ku gjatë tërë vitit është përkujdesur në ofrimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve sportive, kulturore e rinore:***

### ***Shtëpia e Kulturës “Xhavit Haziri”***

Në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” janë realizuar aktivitete kulturor-artistike të prezantuara mësipër, njëkohësisht janë mbajtur ushtrimet e rregullta nga AKV “Qyteti i Obiliqit” dhe ushtrimet

skenike e teatrale të Teatrit të Qytetit, aktivitete të tjera nga OJQ-të e Komunës së Obiliqit, dy shfaqje të baletit nga shkollat e baletit “Pirouette” dhe “Melody” dhe shfaqja e baletit nga studio “Nesa”.

### **Palestra Sportive “Adem Jashari”**

Në Palestrën Sportive “Adem Jashari”, janë realizuar stërvitjet e rregullta të klubeve, ndeshjet miqësore dhe aktivitete të tjera sportive, nuk ka pasur asnjë ndërprerje të aktiviteteve gjatë kësaj periudhe.

### **Biblioteka e Qytetit**

Në Bibliotekë e Qytetit ka vijuar puna e rregullt, njëkohësisht, kemi bashkëpunuar me dashamirës të librit: mësimdhënës, nxënës, shkrimtar , në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rreth lexushmërisë.

### ***Në nderim të të rënëve për liri e shtet ndërtim, Drejtoria për Kulturë ka organizuar:***

Ceremoni të homazheve për nder të Epopesë së UÇK-së, 5-6 dhe 7 Mars, pranë “Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve” në Sheshin e qytetit dhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmoreve të familjes Rama, Martirëve të familjes Halimi dhe Haliti”.

Ceremoni të homazheve në nderim të të rënëve të familjes Morina, pranë Pllakës përkujtimore në Milloshevë.

Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Ferit Curri”, pranë lapidarit në fshatin Mazgit.

Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Fejzullah Grajçevci”, pranë Pllakës Përkujtimore në fshatin Graboc.

Ceremonia e homazheve në nderim të Dëshmorëve të Kombit- Shënimi i 5 Majit “Dita e Dëshmorëve të Kombit” , pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve në Sheshin e Qytetit “Dëshmoret e Kombit”.

Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Murat Krasniqi”, në Stanoc.

Nga ky takim u nxorren propozime rreth hartimit të draft dokumentit të Hartës Zonale, ku pastaj të njejtat do të inkorporohen në kuadër të dokumentit dhe do të dërgohet në MMPHI për marrjen e pëlqimit dhe kështu përfundimisht të rrumbullaksohet puna disa vjeqare dhe të kompletohet infrastruktura në aspektin e planifikimit ku rrjedhimisht do të kemi për 8 vitet e ardhshme Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës së Obiliqit.

Zyra për informim, Obiliq.



-Puna rreth këtij dokumenti me një seriozitet dhe përkushtim të madh është drejt përfundimit në mënyrë që të dorëzohet për marrjen e vendimit për pëlqim nga MMPHI-ja.

-Përveq punës në hartimin e Hartës Zonale sektori i Urbanizimit njëkohësisht ka kryer punët e tjera të cilat janë përgjegjësi e këtij sektori.

-Kemi paisur palët me leje ndërtimore për lëndët të cilat kanë qenë të paisura me kushte ndërtimore

-Kemi paisur palët me dokumente në mënyrë që t'iu mundësohet aplikimi në Ministrinë e Bujqësisë për përfitim të granteve qeveritare e poashtu edhe pëlqime për rregullim të dokumentacionit për palët të cilat kanë aplikuar në MMPHI për vendosjen e Paneleve Solare.

**-Takim me auditorë, lidhur me procedurat e paisjes me leje ndërtimore për vitin 2023- ashtu siq është vepruar çdo vit.**

**-Si dhe shumë punë të tjera që janë të lidhura me sektorin e urbanizmit, duke cekur edhe konsultimet me palë lidhur me punët që i takojnë natyrës së punës tonë.**

---

-Kjo ka qenë një përmbledhje e shkurtër e punëve të sektorit të urbanizmit gjatë vitit 2023.

**-Më poshtë do të cekim lëndët që janë të lidhura me të hyrat në sektorin tonë.**

- 5 vendime për kushte ndërtimore,

- 6 vendime për leje ndërtimore,
  - 12 leje përdorimi,
  - 0 leje rrënimi,
  - 2 vendime për refuzim,
  - 14 pelqim ,
  - 62 përgjigjëje palëve,
  - 6 njoftime për qytetarë në kërkesat e ndryshme.
- 
- 92 vendime të legalizimit të objekteve për kategorin e parë
  - 1 vendime të legalizimit të objekteve për kategorin e dytë.
  - 65 vendime të legalizimit për listë të pritjes.

Të hyrat nga lejet ndërtimore : 13 429.27 €

Të hyrat nga legalizimi i objekteve: 10 536.72 €

Total të hyrat nga sektori i Urbanizmit **23 965.99 €**

Andaj mbi bazën e gjithë asaj që u cek më lartë si të hyra nga Drejtoria e Planifikim Urban , Pronë dhe Kadastër gjatë vitit 2023 janë realizuar si në vijim :

<b>Spektori i Urbanizmit :</b>	<b>23 965 .99€</b>
<b>Sektorët - Gjeodezi Pronë dhe Kadastër :</b>	<b>90,935 €</b>
<b>Totali :</b>	<b>114,900.99 €</b>

### **NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE**

Raport i punës për periudhën vjetore të vitit 2023.  
Gjatë këtyre muajve kemi zhvilluar këto procedura.

#### **- Rekrutim – Pranim nga jashtë :**

Gjatë këti viti kemi zhvilluar gjithësej 30 rekrutime të punëtorëve. Prej tyre 7 punëtor janë pranuar nga konkurset e vitit 2022 dhe 8 konkurse janë në procedurë të rekrutimit.

**-Konkurse:** Gjatë vitit 2023 kemi shpallur 30 konkurse, prej tyre një(1) i brendshëm dhe njëzet e nëntë(29) të jashtëm gjithashtu 8 prej tyre janë në procedurë të rekrutimit- **Rekrutime / Lëvizje brenda kategorisë :**

Përmes konkursve kemi pasur lëvizje të mësimdhënësve nga një Institucion arsimor ne tjetrin.

#### **-Ngritje në detyrë**

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur ngritje në detyrë.

**- Emërimi i Drejtorit në SHFMU ”Naim Frashëri “ me dat.03.04.2023 me mandat katër vjeçar e emëruar Ragbeta Gashi.**

**-Përfundim i periudhës provuese :**

Gjatë vitit 2023 kemi pasur punëtor që në bazë të nenit 10 pika 5 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 mbi përvojën e punës 10 vjeqare kanë fituar të drejtën e kontratës së përhershme dhe disa kanë përfunduar periudhën provuese.

**-Autorizim për zëvendësim :**Nuk kemi.

**-Klasifikimi i vendeve të punës** sipas Ligjit të ri të pagave dorëzimi i listave për zyrtarët publik në MPB/DMZP .

**-Ankesë e brendshme :**

Nuk kemi.

**-Ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës**

Nuk kemi.

**-Komision Disiplinor :**

Kemi pasur një rast dhe vendimi është marrë që të hidhet poshtë si e pabazuar.

**-Pushime :**

Pranimi i kërkesave për pushime dhe mbajtja e evidencave për të gjithë punonjësit.

**-Listat e pagave** pranimi dhe dorëzimi tek drejtorët e institucioneve arsimore, nënshkrimi nga të gjithë të punësuarit, kontrollimi dhe barazimi me DBF për Drejtorinë e Arsimit.

**-Ndryshimet në lista të pagave .**

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur ndryshime në listat e pagave (norma) Përgaditja e formularëve dhe dërgimi i formularëve në sistemin e pagesave MF për secilin muaj.

Gjashtë (6) mësimdhënës kanë bërë ndrrimin e bankës.

**-Pagesa Retroaktive :**

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 77 pagesa retroaktive për punë jashtë orarit të punës 13,387.94 euro dhe 47 pagesa për arsimin joformal.

**-Largime** kemi pasur 12 të larguar prej tyre (6) gjashtë pansionista dhe (6) gjashtë të tjerë që kanë qenë zëvendësime të pushimeve të lehonisë.

**-Auditimi i jashtëm / dorëzimi i dokumenteve nga datat 15.05.2023 :**

- Listat e rekrutimeve, pensioneve, lehonave, punë jashtë orarit.
- Planifikimin e pagave për vitin 2022.
- Kontratat e punës dhe vendimet për përvojën e punës.
- Procedurën për pranin nga jashtë për pozitën disa pozita.

**Zyra ligjore për periudhën Janar-Dhjetor 2023 paraqet këtë raport të punës:**

***Shërbimet ligjore të ofruara:***

-**Këshilla juridike** ,për z.e kryetarit, drejtoritë komunale, sektoret ,auditorin e brendshëm, zyrën e personelit në përpilimin e akteve juridike ,vendime ,procedurat e shpronësimit,rregulloret komunale të aprovuara në kuvend sipas propozimeve të drejtorive .

-Përpilimin e kontratave ,memorandumeve për zyrën e kryetarit dhe për të gjitha drejtoritë ,përpilimin e shkresave të ndryshme etj.

-Shqyrtimin e të gjitha kontratave të propozuara nga ana e drejtorive për bashkëpunim me organizatat e ndryshme para se të bëhet nënshkrimi i tyre.

-Përpilimin e vendimeve sipas kërkeses se Kryetarit dhe Drejtorive .

**Përfaqsimet** :Në bashkëpunim me avokatin janë bërë mbi **378 veprime** juridike –gjqëaore duke përfshirë ,padit shkresa ,përgjigje në padi,parashtrësia të ndryshme për gjykatë , mbajtje të seancave gjyqësore si dhe sigurim të provave sipas kërkesës së gjykatave,prapsime tek permbaruesi menaxhimi i kontratës dhe shume veprime tjera.

-Pranimi i të gjitha lëndëve gjyqësore përmes arhivës ,shqyrtimin e tyre ,regjistrimin në regjister te evidences si dhe kompletimin e lendeve per ti dorëzuar tek avokati.



Pregatitja e raportit për shpenzime kontigjente për vitin 2024 të bartura nga viti 2023 ku arrinë vlerën afer 2,706.907.38 euro, në këtë raport nuk janë përfshirë kontestet të cilat nuk ju dihet vlera deri në marrjen e ekspertizës si dhe kontestet pronësore që kanë të bëjnë me vërtetimin prone.

Në vitin 2023 sipas kërkesës së DEFZH zyra ligjore ka përgatitur dhe dorëzuar tek përmbaruesit 20 lëndë që kanë të bëjnë me mospagesë të taksave në sektorin për ekonomi dhe zhvillim dhe në sektorin e tatimit në pronë .

Këto lëndë janë ende në procedurë pasi që debitorët kanë ushtruar prapsim ndërsa z.ligjore ka kthyer përgjigje në prapsim, në lidhje me këto raste z.ligjore është në kontakt me përmbaruesit privat duke përcjellur procesin.

**-Përcjelljen e ligjeve ,Rregulloreve dhe udhëzimeve administrative përmes ueb faqeve të Kuvendit të Republikës Kosovës dhe Qeverisë.**

**-Pjesmarrje në takimet** e rregullta të kolegjiut të zyrtarëve ligjor në kuadër të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës

**-Hartimi i raportit për shpenzime kontigjente** për auditorin gjeneral

**-Këshilla për zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative të cilat vijnë nga niveli qendror, sipas kërkesave të drejtorive .**

**-Pjesmarrje të rregullta** në mbledhjet e komitetit për politikë dhe financa dhe mbledhjet e Kuvendit të Komunes ku në bashkëpunim me sekretarinë e Kuvendit dhe me kryesuesen bëjmë përpilimin e akteve të ndryshme nga fushëveprimtaria e kuvendit komunal

**-Takime të rregullta me Avokatin e Komunës**, bashkëpunim dhe koordinim të punës në çështjet gjyqësore, përpilimin e përgjigjeve në padi dhe shkresa tjera, sigurimin e provave nga ana e drejtorive përgjegjëse për secilën lëndë që i përket atyre ,pjesmarrje në seanca gjyqësore dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me të gjitha lëndët gjyqësore në cilësinë e palës paditëse dhe të paditur.

## **Raporti i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB) – Komuna Obiliq, viti 2023**

Funksioni i auditimit të brendshëm në Komunën e Obiliqit realizohet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm që funksionon si njësi e pavarur dhe aktualisht përbëhet vetëm nga Udhëheqësi i Auditimit të Brendshëm (*NjAB me organogram ka edhe një pozitë të lirë Auditor i brendshëm, e cila është në proces të rekrutimit*).

Njësia e Auditimit të Brendshëm, funksionon në bazë të kornizës ligjore të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe kornizës profesionale të vendosur nga Njësia Qëndrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB) në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), që mbështet vlerat kryesore të ligjshmërisë, integritetit, objektivitetit, besueshmërisë, kompetencës dhe pavarësisë, gjithashtu zbaton gjithë legjislacionin në fuqi dhe standardet e auditimit të brendshëm.

NjAB, duke u bazuar në planin vjetor, rreziqet, standardet dhe praktikat e auditimit të brendshëm, ka kryer tre (3) auditime të brendshme në vitin 2023, që janë si vijon:

1. Menaxhimi i aktiviteteve të prokurimit
2. Menaxhimi i shërbimeve, dokumenteve dhe të hyrave nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
3. Menaxhimi i pasurive jofinanciare

Secilit auditim i ka paraprirë një takim fillestar me drejtorin/udhëheqësin e drejtorisë apo sektorit të audituar, ku janë diskutuar qështje relevante me auditimin, siç janë: objektivat, fushëveprimi, pasqyra e procesit të auditimit, mënyra e komunikimit, personi kontaktues etj.

Gjatë auditimeve kemi testuar dokumente të ndryshme nga ku kemi hasur në të gjeturat që i kemi shpalos në raporte, për përmisimin e të cilave i kemi dhënë njëzetetre (23) rekomandime.

Në fund të secilit proces të auditimit, me lëshimin e raportit final të auditimit, drejtorive/njësive përkatëse u'a kemi përcjellur edhe dokumentin "*Plani i veprimit të menaxhmentit*" për ti paraqitur veprimet që do të ndërmerren për implemtimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB. Planet e veprimit të plotësuar nga menaxhmenti, i kemi pranuar, kemi mbajtur takime me të audituarit

(menaxhmentin), të cilët edhe janë zotuar se rekomandimet do të zbatohen konform Planit të veprimit.

**Nga njëzetetë (23) rekomandime të dhëna në vitin 2023, dymbëdhjetë (12) janë zbatuar, ndërsa njëmbëdhjetë (11) janë adresuar dhe janë në proces të zbatimit** (disa nga rekomandimet e kanë pasur të pamundur të zbatoheshin në vitin 2023, për shkak të kohës së kufizuar sepse raportet janë lëshuar në dhjetor 2023).

Në mënyrë të përmblodhur po e paraqesim numrin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB në vitin 2023, dhe nivelin e zbatimit të tyre nga Komuna, përkatësisht drejtoritë/njësitë përgjegjëse.

*Tabela Nr.1, Numri i rekomandimeve në vitin 2023, dhe niveli i zbatimit të tyre*

Nr	Auditimet e kryera/Titulli i auditimit	Numri i rekomandimeve të dhëna 2023	Të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara (Të adresuara - në proces të zbatimit)	Të pa zbatuara
1	Menaxhimi i aktiviteteve të prokurimit	8	7	1	
2	Menaxhimi i shërbimeve, dokumenteve dhe të hyrave nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	10	5	5	
3	Menaxhimi i pasurive jofinanciare	5		5	
<b>Totali</b>		<b>23</b>	<b>12</b>	<b>11</b>	

NjAB, ka planifikuar që përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve (të cilat janë në proces të zbatimit por nuk janë zbatuar) të dhëna në vitin 2023, ta bëjë në fillimin të prillit 2024.

#### NJAD-ZBGJ

Janar-Pjesmarja në takim me anëtarët e performances  
Janar-Takim me KFOR-in. zviceran

Janar-Pjesmarja në debatin public për rregulloren të kodit etik  
Janar-Takim të rregullt në ABGJ

Janar-Pjesmarja në puntori dy ditore organizuar nga ZQM

Janar -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal  
Janar -Monitorimi i komitetit për financa  
Janar -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjimore :F: 9M:12

Shkurt-Takim me përfaqësuesen e organizates 99 lule,takimi kishte për qëllim kordinimi për projektin e përbashkët.

Shkurt-Pjesmarja në takim tek MAPL ,takimi kishte për qëllim funksionimi i njërive nepërkomuna.

Shkurt-Takim me OJQ Shqiponjat e Dardanes”për realizimin e projektit “Vajzat për Vajzat’projekt ky I cili do të realizohet në Shkollat e mesme trejnime me vajzat e shkollave në fushën e programimit

Shkurt-Vizit tek familja Agjanqiq(pas vizites u ba raport nga rasti ne fjal)

Shkurt-pjesmarja në takimin për hartën zonale

Shkurt-Pjesmarja në puntorin ditore të organizuar nga ABGJ në bashkëpunim me IKAP , me temën “parandalimi dhe trajtimi i rasteve rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës”ku jemi qertifiku në këtë fushë

Shkurt-Pjesmarja në mbledhjen e KKSb-së

Shkurt-Pjesmarja në puntorin ditore të organizuar nga ABGJ -takimi kishte për qëllim prezentimet e planeve të punës 2023 para donatorve

Shkurt-takim me drejtorat e shkollave të mesme pregaditja dhe kordinimi i grupeve për fillimin e trajnimit me vajzat e shkollava

Shkurt -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Shkurt -Monitorimi i komitetit për financa

Shkurt -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Mars-Në kuadër të muajit mars, muajit të Gruas , në bashkëpunim me OJQ “Shqiponjat e Daradnës”, kemi filluar aktivitetin trajnues në kuadër të projektit By Girls For Girls “me vazjant e shkollës së Mesme të Lartë Profesionale “Ismail Dumoshi”.

Qëllimi i këtij projektit është që të edukojë dhe frymëzoj vajzat që të përdorim aftësit STEAM për të promovuar barazin gjinore.

Ky projektë do të zgjasë për 6 javë dhe të gjitha nxënëset do të qertifikohen me qertifikata nderkombetare .

Mars-U mbajt takimi me grupin e parë të grave , në kuadër të projektit, “Përfshirja e Grave në Agrobiznes “, në këtë takim pjesëmarrëset u informuan për hapat që do të ndërmmarrë komuna për realizim e këtij projektit.

Mars- Në kuadër të muajit mars, muajit të Gruas, së bashku me kryetarin kemi prit në takim znj. Havushe Bajrami Bunjaku, përfaqësuese e ndërrmarjës “99 lule”, qëllimi këtij takimi ishte rreth përkrahjes së grave në agrobiznes dhe mbështetjen e tyre, mbështetje kjo e cila do ti

realizoi dhurimin e fidaneve për mbjelljen e bimëve mjekuese dhe aromatike dhe sigurimin e tregut nga ana e saj.

Mars-Takim me prf. Të UNMIK-ut, takimi kishte për qëllim bashkpunim mes ZBGJ dhe UNMIK. Mars-14 dhe 15 mars pjesëmarrja në konferencën "Javën e Gruas 2023", të organizuar nga IND KOSOVO.

Mars-U bajt takimi i rregullt i Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje, ku u diskutua gjendja e rasteve të dhunës në familje.

Maras-Pjesmarja në takim në MAPL divizioni për të drejtat e njeriut dhe baraza gjinore  
Mars-Pjesmarja në takimin e performances

Mars-mbledhja e te dhenave dhe statistikave gjinore në drejtori  
Mars-Takim me prf. Të OSBE-së, lidhur me hartimin e fletushkes për të arriturat gjinore në Komunën tone.

Mars-Pjesmarja në puntorin dy ditore "Diskriminimi në vendin tone" organizuar nga ZQM-finansuar nga komisioni evropian

Mrasr-Takim me grupin e Grave në komunën e Lipjanit, takimi kishte për qëllim njoftimi me praktikatat e mira të komunës tone.

Mras Ttakim me prf.e OJQ -QPDG , takimi kishte për qëllim bashkëpunimi në mes qendres dhe zyres tone.

Mars-Pjesmarja në kuvendin zgjedhor të gruas në organizaten e pleqëve

Mars -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Mars -Monitorimi i komitetit për financa

Mars -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Qershor-Zyrtarja për të Drejtat e minoriteteve kishte takim me përfaqësues të të rinjëve nga Babimofci ,cilet janë aktivitetet sportive mujn të finansohen nga komuna

Qershor-Zyrtarja për të drejtat e minoriteteve ,kishte takim me një nënë vetushqyese nga minoriteti rom e cila kerkonte mbeshtetje për start-tap biznes

Gusht-Pjesmarja në takimin e rregullt të ABGJ

Gusht-Takim me drejtoreshen e Strehimores

Gusht-Pjesmarja në takimin e rregullt të aktivitetit të gruas shoqata e pensionistëve

Gusht-Pjesmarja në dëgjimin publik të buxhetit

Shtator-Pjesmarja në takim në komunën e Fushë-Kosovës,ku u diskutua pozita e gruas në nivel lokal në regjionin e Prishtinës.

Shtator-Vizit Ministrin e ***Punëve të Brendshme*** divizionin kundër dhunës në familje takimi kishte për qëllim funksionimi i mekanizmave koordinues kundër dhunës në familje.

Shtator-Takim të rregullt me ABGJ

Shtator-Pjesmarja në puntori ditore tema:Pozita e gruas në parti politike,organizuar nga IRDK.

Shtator-Takim në Ministrin e Pushtetit Lokal divizionin për të drejtat e njeriut dhe baraza gjinore.

Shtator-Takim me kryesin e aktivitetit të gruas në shoqatën e pensionistëve në Obiliq.

Shtator-Takim me OJQ ‘Shqiponjat e Dardanës’

Shtator-Pjesmarja në puntorin dy ditore me temen:Roli i grave anëtare të Komunave dhe grave partnere për ti adresuar qështjet e sigurisë,organizuar nga OSCE-ja.

Shtator-Pjesmarja në takimin e rregullt të aktivitetit të gruas në shoqatën e pensionistëve, takimi kishte për qëllim bashkëpunimi mes nesh.

Shtator-Pjesmarja në dëgjim publik buxhetor komunal për vitin 2024 dhe parashikimin për vitin 2025-2026.

Shtator-Takim me prf. Të OSCE-së sektori i dhunës në familje .

Shtator-Takim me prf. Të rrjetit të grupit të grave,takimi kishte për qëllim bashkëpunimi mes nesh.

Shtator-Pjesmarja në” week of women “ Organizuar nga NDI Kosovo 2023.

Shtator-Trajtimi i një rastit nënë vetushqyese.

Shtator-Raportim në ABGJ

Shtator-Takim me perf.UN Women takimi kishte për qëllim bashkëpunimin mes nesh.

shtator -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

shtator -Monitorimi i komitetit për financa

shtator -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjimore :F: 9M:12

Tetor-Pregaditja raportit të monitorimit të PKBGJ-se për ABGJ

Tetor -Prëgaditëja raportit të monitorimit të PKBGJ-se për ABGJ

Tetor -Takim me prf.të USAID-it njoftim lidhur me zhvillimin e projektit “AKTIVITETI QEVERISJA E PRONËS”

Tetor-Përgaditëja dhe finalizimi për implementimin e projektit “Integrimi i Personave me Nevoja të Veçanta”

Tetor -Takim me prf.”99 Lule”finalizimi i projektit” Gratë në Agrobiznes”

Tetor -Pjesëmaria në takimin e rregullt të aktivitetit të gruas në shoqatën e pensionistëve

Tetor -Takim në ministrin e kulturës departamenti i trashëgimis(artizanatet e grave në kohrat e hershem)

Tetor -Takim në Vushtrri,me të gjitha zyrtaret ZBGJ ,shkëmbim përvojash dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta

Tetor -Shënimi i muajit Tetor-muajin Rozë në komunën tone

Tetor-Pjesëmaria në takimin e rregullt në ABGJ-ZKM



Tetor-Hapja e shënimit të muajit Tetor muaji i barabart për të gjithë me PAK (fillimi I praktikës në administratën komunale)

Tetor -U realizua punëtorja e pare për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore ,në kuadër të projektit “Gender Equality Facility”zbatua nga UN Women në Kosovë,financuar nga Bashkimi Evropian

Tetor -Pjesëmaria në ligjeratën Kundër Kancerit të gjirit tek aktivi i gruas në shtëpinë e pleqëve

Tetor -Pjesëmaria në punori “Ngritja e kapaciteteve për të drejtat e komunitetit në procesin e tranzicionit të drejtë”organizuar nga Qendra Rinore

Tetor -Në bashëpunim me kryesuesen e Grupit të Grave, dektorin e shëndetësis,me rastin e muajit Tetor-muajit rozë,kemi organizuar ligjeratë vetdijesuese ndaj kancerit të gjirit me grate e viseve rurale

Tetor -Pjesëmaria në Puntori me temën “Antigjiptizmi”organizuar nga MAPL

Tetor -Në kuadër të kampanjës ,Tetori-muaji i barabart për të gjithë, Kryetari së bashkë me drejtoreshën e DAP-it,NJAD,kemi pritur në takim persona me nevoja të veçanta ,ku komuna jonë ka shënuar këtë muaj me aktivitete të ndryshme

Tetor -Pjesëmaria në seancën e kuvendit komunal

Tetor -Me rastin e muajit ndërkombëtar në luftimin e trafikimit me qenie njerzore kemi zhvilluar aktivitet në kuadër të fushatës vetëdijesuese kundër trafikimit me njerzë

Tetor -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Tetor -Monitorimi i komitetit për financa

Tetor -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Nëntor -Agjencia për Barazi Gjinore /ZKM në bashkëpunim me zyren tone kemi organizu trajnim me temen “Parandalimi dhe Trajtimi i rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës “

Nëntor-U realizua puntoria e dytë për hartimin e “Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore”,në kuadër të projektit “Gender Ekuality “zbatuar nga UN Women dhe financuar nga Bashkimi Evropian

Nëntor-Takim me drejtorin/drejtreshen e shkollave të mesme bashkëpunimi për fushatën 16 ditët e aktivizimit

Nëntor -Takim pune me grupin punues për hartimin e planit të veprimit për baraza gjinore 2024-2026

Nëntor-Pjesmarja në puntorin 3 ditore rreth finalizimit të draft dokumentit të hartës zonale 2023-2031 ,kjo puntori u mbajt në Pogradec

Nëntor-Në bashkëpunim me N.G.O “Agromedicine”kemi fillu implementimin e projektit gratë Agrobiznes.

Ky project do të zhvillohet me dy grupe të grave,faza e parë janë përfitueset e 5 (persë)serave për 5 (pesë) gra të mbështetura nga UNMIKu,dhe faza e dytë një grup prej 10 (dhjetë)grave që do të merren bimë shëruese aromatike,ku të gjitha kto gra do të trajnohen dhe certiofikohen nga agronomet nga kompania N.G.O “Agromedicine”

Ky projekt vazhdon në vitin 2024

Nëntor -Në kuadër të fushatës vetëdijesuese kundër dhunës me bazë gjinore,mbështetur nga USAID-I,aktiviteti Qeverisja e pronës është organizuar diskutim me qytetarët e komuniteteve pakicë me temën nën slloganin:

***“Sot dhe çdo ditë tjetër, Si mund ta zvogëlojnë të drejtat pronësore rrezikun nga dhuna me bazë gjinore”***

Nëntor -Takim me KFOR-in, zviceran

Nëntor-Në kuadër të aktiviteteve të fushatës “16 ditët e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore”është realizuar ekspozitë arti me nxënësit e shkollave të mesme nënë slloganin”Sot dhe çdo ditë tjetër”duke shprehur format e dhunës përmes artit

Nëntor -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Nëntor -Monitorimi i komitetit për financa

Nëntor-Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Dhjetor-Pjesmarja në puntorin ditore projekti i USAJD-it,Qeverisa dhe Prona ,takim ky i cilli u realize me 6 komuna partnere

Dhjetor-Pune me grupin punues për hartimin e planit për baraza gjinore 2024-2026

Dhjetor-Takim me prf. Të komisionit për të drejtat e njeriut dhe baraza gjinore në kuvendin e Kosovës

Dhjetor-Mbahet diskutimi public për Draft-Matricën “Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026”

Dhjetor-Mbahet takimi i rregullt i Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje

Dhjetor-Pjesmarja në komisionin vlerësues për çmimet për Mirënjohje Publike

Dhjetor-Pjesmarja në puntorin ditore “Monitorimi I të drejtave të pakicave në nivel lokal”organizuar nga Qendra Rinore

Dhjetor -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Dhjetor -Monitorimi i komitetit për financa

Dhjetor -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjimore :F: 9M:12

### Zyrtar për integritet evropiane

Duke e ditur rëndësinë e procesit të integriteteve evropiane dhe fuqizimit të rrugëtimit të Kosovës drejt këtij procesi, si dhe me qëllim të harmonizimit të veprimeve dhe koordinimit të aktiviteteve ndërmjet Komunave, Ministrisë së Integriteteve Evropiane, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Punëve të Brendshme kam kryer raportim të rregullt në tre mujorë, gjashtë mujor, nëntë mujor, një vjetorë si dhe sipas nevojës dhe kërkesës nga Ministrit e linjës raport mujor apo add-hoc raport në koordinim me Kryetarin e Komunës, Drejtorët Komunal, departamentet e caktuara për koordinim, për zbatimin e detyrave të komunës që dalin nga Plani i Veprimtimit për Partneritet Evropian, **njëherë falënderoj Kryetarin e Komunës, shefin e kabinetin me të gjithë kabinetin, Drejtorët , Shefat e departamenteve për bashkëpunime dhe përkrahje të vazhdueshme.**

Zyra për Integrim Evropian në komunën e Obiliqit bashkëpunon ngushtë me Agjencinë për Integrim Evropian (AIE) për qëllime të bashkërendimit të aktiviteteve në kuadër të procesit të Integrimit Evropian.

Marre pjesë në takimet që organizohen çdo muaj në MAPL rreth të rejave në fushën e integrimi evropiane, liberalizimin e vizave etj.

**Në janar** me kërkesë nga MAPL-ja më është kërkuar që të hartoj Raportin një vjetarë janar-dhjetor 2022, raportin e kam hartuar dhe në afatin e kërkuar e kam dorëzuar, gjithë ashtu pres edhe përcjelljen e shumë raporteve një vjeçare të cilat i kërkojnë departamentet e ndryshme në ministrin e linjave të Republikës së Kosovës,

**Në janar** me kërkesën e Asociacionit të komunave kemi mbajtur takimin e rregull të Kolegjiumit të zyrtarëve për integrim evropian, me qëllim të shqyrtimit të planit të punës, si dhe përcaktimin e aktiviteteve në kuadër të koordinimit dhe zhvillimit të veprimtarisë të kolegjiumit.

**Në janar** me kërkesën e Drejtorit të administratës e kam zëvendësuar zyrtarin TI dhe për shkrime saktësime dhe bartje te postes zyrtare.

**Në janar** me vendim të Kryetarit kam qen anëtar ne disa hapje dhe vlerësim të ofertave.

**Në janar** me vendim të Kryetarit jam caktuar në Komisionin për inventarizimin e pasurisë jo financiare, ku se bashku me anëtarët e komisionit dhe me Drejtorin e Administratës jemi dakordu që punët për inventarizim me sistemin e ri të futjes së dhënave në dhënave në e-pasuri edhe pse sistemi nuk ka funksionuar ne kemi vendosur të dhënat në tabela me shkrim, punë ti kryejmë vetëm në fundjavë që mos ta pengojmë punën në ditët e punës, por kemi hasur ne probleme dhe ju kam njoftuar ju dhe kemi bere presion në ministri se kemi Probleme Teknike qe ministria ka probleme teknike ne mos funksionimin e sistemit për futjen dhe nxjerrjen e te dhënave siç kërkohet me ligj.

**Në janar** kam raportuar tek Kryetari i Komunës dhe të gjitha sektorët për arritjet dhe ngecjet në rrugën drejt BE dhe për obligimet.

**Në janar** me kërkesë nga Kryetari dhe Drejtori e administratës kam qen anëtar ne hapje dhe vlerësim të disa tenderëve

**Në shkurt** me vendim nga Kryetari i Komunës po ashtu me kërkesën e Drejtorit të administratës kemi punuar në organizimin e festes se Pavarësisë si dhe e kam ndihmuar

zyrtarin e IT për rivendosjen e pajisjeve elektronike, kam zëvendësuar zyrtarin për përshkrime saktësime dhe bartje te postes zyrtare deri në fund të muajit.

**Në shkurt** Duke e ditur rëndësinë e procesit të integritit evropian dhe rrugëtimit të Kosovës drejt BE-së, si dhe me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, harmonizimit të veprimeve dhe koordinimit të aktiviteteve me komunat, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkë organizim me Ministrin e Integritit Evropian, kemi marr pjesë në punëtorinë ku prezantohen mundësitë për financim nga programet e BE-së.

**Në shkurt** në takimin e kolegjiut për integritime evropiane kemi rishikuar planin e punës 2023 dhe kemi marr informacione për raportin e fundit kombëtar ku prej 38 komunave të Republikës së Kosovës Komuna e Obiliqit si gjithë here është nder me te mirat në përmbushjen e standardeve, po ashtu propozohet formimi i planin për mbrojtjen e trashëgim kulturore, plani integritetit është ne proces dhe do te përfundoj me kohe etj, ku kam biseduar me zyrtarë të kulturës, administratës e kuvendit dhe me kanë premtua qe brenda vitit do te kryhet.

**Në shkurt** me kërkesë nga Kryetari i Komunës jam caktuar në disa hapje dhe vlerësim të një tenderi .

**Në shkurt** kam Raportuar për fondet e të dhënëve për OJQ-të për vitin 2022-23, në MAPL.

**Në shkurt** kemi punuar në Thirrje për Projekt-Propozime: Komunat, institucionet vartëse të saja, si dhe organizatat e shoqërisë civile.

**Në shkurt** kemi pasur një takim pune, ftesë për takimin konsultativ në qasjen e programeve të BE-së, i organizuar nga MI të organizuar në Komunën e Prishtinës.

**Në shkurt** me kërkesë nga Kryetari i Komunës jemi caktuar prapë ne inventarizim ku kemi punuar për inventarizimin-regjistrimin e pasurisë jo financiare.

**Në mars** me ftesë nga IKAP-i kam marr pjese në një trajnim dy ditor me temën të drejtat dhe puna në mbrojtjen e sinjalizuesve.

**Në mars** me kërkesë nga Kryetari i Komunës kemi punuar për inventarizimin-regjistrimin e pasurisë jo financiare.

**Në mars** me kërkesë nga MAPL-ja kam raportuar për Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat dhe për numri i Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të themeluara.

**Në mars** ftesë- Ceremonia Përmbyllëse dhe Dhënia e Grandeve, të organizuar nga USAID.

**Në mars** me terkes nga MAPL kam Raportuar për posedimin e Planit Anti korrupsion të cilin e ka Komuna dhe miratimin nga kuvendi komunal.

**Në mars** si Kolegji i zyrtarëve për integrim evropian kemi dërguar rekomandime nga ana e Kolegjiutit përmes AKK-së, Ministria e Integrimi Evropiane.

**Në mars** me vendim të Kryetarit kam qen anëtar ne disa hapje dhe vlerësim të ofertave.

**Në prill** me kërkesë nga MAPL-ja kam raportuar për pozitën udhëheqëse në Komunë.

**Në prill** me kërkesë nga Asociacioni i Komunave kam raportuar për Rregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe Planin e Veprimit.

**Në prill** me vendim të Kryetarit kam qen anëtar ne disa hapje dhe vlerësim të ofertave.

**Në maj** me kërkesë nga Kryetari i Komunës jam caktuar në komisionin për aktivitete të prokurimit .

**Në maj** me kërkesë nga Kryetari i Komunës kemi punuar me grupin për inventarizimin-regjistrimin e pasurisë jo financiare.

**Në maj** kam pranuar ftesat për trajnime nga IKAP-i me kolegjiutit e zyrtarëve për IE.

**Në maj** kërkesë nga Drejtoria e Kulturës për nder të ditëve të dëshmorëve kam marr pjesë në organizim.

**Në maj** kërkesë nga Qeveria kam raportuar për Perceptimin e nëpunësve civil mbi diskriminimin në administratë publike në R. e Kosovës dhe perceptimin e qytetarëve mbi diskriminimin.

**Në maj** kërkesë nga MAPL-ja kam raportuar për Planin Komunal për integritet dhe miratimin.

**Në maj** kërkesë nga MAPL-ja kam raportuar për zyrën për Kthim dhe Komunitete dhe përbërjen e zyrës me përfaqësues, përbërjen nga komunitete pakicë në Komunën tonë.

**Në maj** me kërkesë nga MAPL-ja kam raportuar për Planin lokal për Komunitete dhe komitetet komunale në Komunën tonë.

**Në maj** me kërkesë nga MAPL-ja kam raportuar për hartimin e programit të banimit social , funksionimin e bazës të dhënave për banimin social.

**Në maj** me vendim të Kryetarit kam qen anëtar ne disa hapje dhe vlerësim të ofertave.

**Në qershor** kërkesë nga MAPL-ja i kam njoftuar përfaqësuesit e sektorëve komunal dhe nënkryetarin e komunës, ku përfaqësuesit nga MAPL-ja kanë pyetur për të arriturat e komunës në fushën e komunikimit me komunitetin, drejtat e njeriut, integrimet evropiane (raportin e KE-së në veçanti për komunën tonë ku specifikohet problemi me demonin e Mbeturinave në Mirash), urbanizmin etj.

**Në qershor** me kërkesë nga MAPL-ja kam raportuar për transparencën, mediat, komunitetin dhe bashkëpunimin me komunitetin ne komunën ton me qellim të zhvillimit ekonomik.

**Në qershor** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkë organizim me projektin OSBE, na fton të merr pjesë në takimin e përbashkët me temë “Roli i komunave në përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane si dhe Zbatimi i Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 te mbajtur ne Hotel Emerald” .

**Në qershor** me kërkesë nga Ambasada Ceke kemi marr pjese në ngjarjen përmbyllëse me temën Arsimimi gjithëpërfshirës.

**Në qershor** me kërkesë nga Agjensioni anti korrupsion kam raportuar për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e tjera për periudhën janar-qershor 2023.

**Në qershor** me kërkesë nga MAPL-ja Raportoj për te arriturat e komunës dhe obligimet komunale për te arriturat ne agjendën evropiane.

**Në korrik** me kërkesë nga Qeveria kam raportuar për Strategjinë për zhvillimin e turizmit dhe sfidat.

**Në korrik** me kërkesë nga MAPL-ja kam Raportuar për të dhënat për OJQ-të për vitin 2023.

**Në korrik** në MAPL kam dorëzuar Raportin për Obligimin e Komunës nga Agjenda Evropiane/Plani gjithë përfshirës Janar Qershor 2023, në mënyrën elektronike por edhe në PDF.

**Në korrik** kam marr pjese ne hapjen e disa tenderëve dhe në vlerësimin e disa tenderëve.

**Në gusht** me Komisionin për regjistrimin e inventarizimit kemi bere verifikimin dhe regjistrimin e inventarit në disa sektorë.

**Në gusht** si çdo here kam përmbledhur të arriturat e komunës në fushën e integritimit evropian dhe kam raportuar ne MAPL.

**Në gusht** kam marr pjese ne hapjen e disa tenderëve dhe në vlerësimin e disa tenderëve.



**Në gusht** e kam zëvendësuar zyrtarin e teknologjisë dhe zyrtarin e saktësimeve.

**Në shtator** me Komisionin kemi vazhduar regjistrimin e inventarizimit kemi bere verifikimin dhe regjistrimin e inventarit në disa sektorë.

**Në shtator** e kam zëvendësuar zyrtarin e teknologjisë dhe zyrtarin e saktësimeve.

**Në shtator** kam marr pjesë në hapje dhe vlerësimin e disa tenderëve.

**Në shtatorë** me kërkesën e Asociacionit të komunave kemi mbajtur takimin e rregull të Kolegjiut të zyrtarëve për integrim evropian.

**Në shtator** kam marr pjese ne hapjen e disa tenderëve dhe në vlerësimin e disa tenderëve.

**Në tetor** kam pasur takime të rregullta me ministrit e linjës rreth të rejave në fushën e integrimiave evropiane ku takimin e kemi mbajtur dy ditë me Ministrin e Integrimit Evropian etj.

**Në tetor** me Vendim nga Kryetari për Inventarizimin e pasurisë jo financiare Vendimi koordinim me Këshilltarin e Kryetarit dhe me Komisionin për inventarizimin e pasurisë kemi punuar jashtë orarit të punës duke filluar nga ora 08/09 deri 16/17 në regjistrimin e inventarizimit, kemi bere verifikimin dhe regjistrimin e inventarit në të gjithë objektin e Shtëpisë se Kulturës “Xhavit Haziri” futjen e të dhënave ne kompjuter dhe kemi punuar duke filluar nga ora 08 deri 16 në regjistrimin e inventarizimit, kemi bere verifikimin dhe regjistrimin e inventarit në të gjithë objektin e Sallës së Sporteve “Adem Jashari” futjen e të dhënave në tabela dhe në kompjuter, por me problemin e futjeve te dhënave ne sistem ne ministri etj.

**Në tetor** kam marr pjese në hapjen e disa tenderëve dhe në vlerësimin e disa tenderëve.

**Në tetor** kam raportuar në MAPL-për Bashkëpunimin Ndër komunal dhe vlerësimin e nevojave të komuniteteve.

**Në tetor** kam marr pjese në takimin punues me Entin e Statistikave për regjistrimin e popullsisë 2023.

**Në tetor** kam marr pjese ne hapjen e disa tenderëve dhe në vlerësimin e disa tenderëve.

**Në nëntor** kam marr pjesë trajnimin për mbrojtjen e sinjalizuesve të organizuar nga IKAP-i.

**Në nëntor** me komisionin për regjistrimin e inventarit e kemi vazhduar punën dhe e kemi dorëzuar Raportin e rregullt mujor.

**Në nëntor** me Vendim nga Kryetari për Inventarizimin e pasurisë jo financiare Vendimi, në koordinim me Këshilltarin e Kryetarit dhe me Komisionin për inventarizimin e pasurisë kemi punuar jashtë orarit të punës duke filluar nga ora 08/09 deri 16/17 në regjistrimin e inventarizimit, kemi bere verifikimin dhe regjistrimin e inventarit në të gjithë objektin e Depos së komunës-Arshivës futjen e të dhënave ne tabela dhe në kompjuter dhe kemi punuar duke filluar nga ora 08/09 deri 16/17 në regjistrimin e inventarizimit, kemi bere verifikimin dhe regjistrimin e inventarit në të gjithë objektin e Sallës së Kuvendit Komunal futjen e të dhënave në kompjuter, por me problemin e futjes se te dhënave ne bazën e te dhënave ne ministri ku er kam shprehur kete problem dhe kam kërkuar dhe na zyra e IT dhe ministria rreugullimin e këtij sistemi etj.

**Në nëntor** kam marr pjese ne hapjen e disa tenderëve dhe në vlerësimin e disa tenderëve.

**Në dhjetor** kam marr pjese ne dy Vizita studimore ne Serbi dhe Shqiperi.

**Në dhjetor** kam marr pjesë në disa trajnime dhe tryeza të organizuar si nga ministrit po ashtu edhe nga organizatat e ndryshme.

**Në dhjetor** në bashkëpunim me të gjithë sektorët komunal raportoju në shume ministri të linjave dhe në disa organizata kombëtare dhe ndërkombëtare për të arriturat vjetore.

**Në dhjetor** kam përgatitur dhe pres per ta dorëzuar ne MAPL raportin janar –dhjetor për obligimet komunale nga agjenda evropiane, Plani gjithëpërfshirës, Janar- Dhjetor 2023- me komente.

**Në dhjetor** kam përgatitur dhe dorëzuar ne ne AKK -agjensionin kundër korrupsion Raportin Janar Dhjetor 2023.

**Në dhjetor** kam përgatitur dhe dorëzuar ne MD- ministrin e Diaspores raportin Janar Dhjetor 2023.

**Në dhjetor** kam përgatitur dhe dorëzuar ne Komune tek Kryetari dhe DA, Raportin Janar Dhjetor per Integritet.

**Në dhjetor** kemi përfunduar inventarizimin e pasurisë jo financiare dhe raportet i kemi dorëzuar, me disa probleme sepse sistemi per futjen e te dhënave ne sistem nuk funksionojke shumicën e kohës.

**Në dhjetor** me kërkesën e Drejtorisë së Administratës e ndihmoj zyrtarin e Teknologjisë informative në të gjitha punët e teknologjisë, kuvendin, zyrën priste, zyrtarin për saktësime, vërtetime dhe bartje të postes letrave zyrtare etj.

**Po ashtu** çdo javë punoj dhe jap raportin javor, afërsisht çdo muaj kam marr pjesë në hapjen dhe vlerësimin e disa tenderëve.

**Çdo ditë** përcjelli punën dhe të rehat në të gjitha sektorët të cilët janë të ndërlidhur me agjentin e integriteteve evropiane, raportoju çdo jave tek shefi i zyrës së Kryetarit për punën javore, përcjelli dhe ndihmoj stafin. Raporti i lartë shkruar pasqyron punën në vija të trasha.





